

KONCESIONE / PARTNERITET **PUBLIK PRIVAT**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Gener 2” sh.p.k / NUIS K58615301M, “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. / NUIS K61814023M dhe “I.D.K - Konstruksion” sh.p.k / NUIS K51408016J me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II”, ndërtesa nr. 12, ABA Business Center, Tiranë.

Procedura konkurruese: Dhënia me koncesion/partneritet publik privat për projektimin, ndërtimin operimin, mirëmbajtjen, rehabilitim dhe transferimin e segmentit rrugor Milot - Thumanë.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim dhe transferim i segmentit rrugor Milot - Thumanë, ku gjurma e kësaj rruge fillon pranë njëjës së Milotit dhe përfundon pranë rrethrotullimit të Thumanës. Aksi shtrihet në rrugën kombëtare SH1(A1). Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit/PPP: 35 vjet
Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 108 datë 08.08.2022

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këto ofertues me ofertat përkatëse të ofruara:

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Gener 2” sh.p.k, “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. dhe “I.D.K- Konstruksion” sh.p.k, me vlerë investimi 44,620,189 Euro pa TVSH;
- Shoqëria “A.N.K” sh.p.k, me vlerë investimi 40,000,000 Euro pa TVSH;
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Salillari” sh.p.k., “Zdravo” sh.p.k. dhe “Infrakonsult” sh.p.k, me vlerë investimi 43,981,706.07 Euro pa TVSH;
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “VEGA” sh.p.k “Everest” sh.p.k dhe “UTS 01” sh.p.k., me vlerë investimi 44,620,200 Euro pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria “A.N.K” sh.p.k,
2. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “VEGA” sh.p.k “Everest” sh.p.k dhe “UTS 01” sh.p.k.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Shoqëria “A.N.K” sh.p.k nuk ka realizuar me shoqërinë “A&E Engineering” sh.p.k, e deklaruar si përgjegjëse për realizimin e Projektimit, një marrëveshje për krijimin e këtij bashkimi operatorësh ekonomik sipas kërkesës të pikës 1.3.1 të nënpikës 1.3 “Eksperienca në Projektim” të pikës 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës nr.

9 të DPK; nuk ka plotësuar kriterin kualifikues “Eksperienca në Ndërtim” ku të vërtetojë se ka përvojë minimale ndërtimore në ndërtimin e veprave të mëdha të artit, sipas kërkesës së pikës I) të germës a) të pikës 1.3.2 të nënpikës 1.3 “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës nr. 9 të DPK, si dhe nuk ka paraqitur deklaratat përkatëse, si përfaqësues ose të secilit prej anëtarëve, sipas përcaktimeve në numrat ix, x, xi të nënpikës 2.1 “Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë” të pikës 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës nr. 9 të DPK.

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “VEGA” sh.p.k, “Everest” sh.p.k dhe “UTS 01” sh.p.k i cili është krijuar nëpërmjet Kontratës së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive nr. 3365 Rep. & nr. 1191 Kol. datë 29.09.2022 me përfaqësues “VEGA” sh.p.k., me administrator znj. Yllka Dungu nëpërmjet Prokurës së Posaçme nr. 3366 Rep. & nr. 1192 Kol. datë 29.09.2022, nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe në përputhje me kërkesat e parashtruara në shtojcën nr. 9 të DPK. Sikurse është parashtruar dhe në kërkesën për sqarim drejtuar Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “VEGA” sh.p.k “Everest” sh.p.k dhe “UTS 01” sh.p.k nëpërmjet shkresës nr. 241/1 prot., datë 10.01.2023, ku ndër të tjera është kërkuar sqarim *“Duke qenë se, në ofertën e dorëzuar prej jush në sistem, në file-et e emërtuara “UTS-01_Vertetim_debie_Oshee” dhe “385-2022_Vertetim_Debie_-_OSHEE” nuk gjendet vërtetim debie OSHEE i shoqërisë “Everest” sh.p.k anëtare e B.O.E, lutem sqarimin tuaj se në cilin file është përfshirë ky dokument”* ndërkohë B.O.E me shkresën nr. 19 prot., datë 12.01.2023 nuk ka dhënë sqarimet e kërkuara nga MIE mbi vërtetimin e OSHEE, por ka përcjellë kopje të vërtetimit debie të lëshuar nga FSHU për shoqërinë “Everest” sh.p.k, të noterizuar në datë 12.01.2023, një dokument i ri i cili nuk ka qenë përfshirë në dokumentacionin e ofertës të dorëzuar nga ky Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive. Pra, shoqëria “Everest” sh.p.k, anëtare e B.O.E nuk ka paraqitur një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, sipas kërkesës së pikës 6 të nënpikës 2.1. “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë” të pikës 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës nr. 9 të DPK.

Ndërsa, janë kualifikuar:

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Gener 2” sh.p.k., “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. dhe “I.D.K- Konstruksion” sh.p.k. në vend të parë, me 95.5 pikë nga 100 pikë të mundshme.
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Salillari” sh.p.k., “Zdravo” sh.p.k. dhe “Infrakonsult” sh.p.k në vend të dytë, me 78.333 pikë nga 100 pikë të mundshme. * * *

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Gener 2” sh.p.k / NUIS K58615301M, “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. / NUIS K61814023M dhe “I.D.K - Konstruksion” sh.p.k / NUIS K51408016J me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II”, ndërtesa nr. 12, ABA Business Center, Tiranë, se oferta e paraqitur më datë 30 Shtator 2022, për marrjen me koncesion/PPP projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitim dhe transferimin e segmentit rrugor Milot-Thumanë, është pranuar.

Afati i negociimit të Kontratës tuaj do të jetë 60 ditë nga marrja e njoftimit të fituesit.

Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Gener 2” sh.p.k / NUIS K58615301M, “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. / NUIS K61814023M dhe “I.D.K - Konstruksion” sh.p.k / NUIS

K51408016J, kërkohet t'i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare\Partneritetit Publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat e Procedurës Konkurruese, në vlerën e 5% e vlerës së projektit. Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Dokument që vërteton pagesën e vlerës së tarifës së ATRAKO-s, referuar nenit 12 të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar.
- Ofertën origjinale të shtypur/printuar ose të shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.01.2023

Ankesa: Nuk ka